



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Tiranë, më 22/ 01 / 2024

13  
KKDM/Nr. .... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

**VENDIM**

Nr. 03, datë 22/01/2024

**PËR**

**MBIKQYRJEN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT PËR REHABILITIMIN E DIGËS SË  
NGJEQARIT TË SHFRYTËZUAR NGA BASHKIA ROSKOVEC**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Neni 20 dhe 27, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 22.01.2024 mori në shqyrtim Kërkesën e Bashkisë Roskovec për miratimin e mbikqyresit të punimeve të ndertimit për Rehabilitimin e digës së Ngjeqarit që shfrytëzohet nga Bashkia Roskovec

Mbikqyresi i punimeve "SELAS" shpk me NIPT J71826005F dhe me drejtues Ligjor dhe teknik ing. Vladimir Agalliu i caktuar nga Bashkia Roskovec për të mbikqyruar punimet për rehabilitimin e digës së Ngjeqarit që shfrytëzohet nga kjo Bashki, sipas dokumentacionit të dorëzuar pranë KKDM rezultoi se është me përvojë në punimet e ndertimit të veprave hidroteknike dhe sidomos të digave dhe është i pajisur me licencën përkatëse për mbikqyrjen e punimeve në diga.

Keshilli Teknik i Perhershëm i Digave (KTPD) i rekomandoi antareve të KKDM të miratojnë Mbikqyresin e punimeve të ndertimit për rehabilitimin e digës së Ngjeqarit sipas kërkesës të paraqitur nga Bashkia Roskovec. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

1. Të miratojnë kompaninë "SELAS" shpk si Mbikqyresin e Punimeve të ndertimit për rehabilitimin e digës së Ngjeqarit të paraqitur nga Bashkia Roskovec.
2. Ti kërkojnë Bashkisë Roskovec:
  - Pas përfundimit të punimeve të Rehabilitimit dhe rivenies në punë të digës së Ngjeqarit, të përgatisin hartat e permbytjeve për kushtet e reja dhe përcaktimin e zonave me rrisht të lartë në rastet e prurjeve maksimale të ujit me përsëritje një herë në 100 vjet, 1 herë në 1000 vjet dhe në rast të prishjes së mundshme të digës
  - Dorëzimin e projektit të zbatimit sipas faktit pas përfundimit të punimeve të parashikuara për rehabilitimin e kësaj dige si dhe dorëzimin e Aktit të Kolaudimit të punimeve për miratim pranë KKDM sipas kërkesave të nenit 25 të VKM Nr. 147 të mesiperme

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

